

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çomo, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë për sa vijon:

Lidhur me kontrollin e figurës

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar pranë Komisionit, raportin mbi kontrollin e figurës, për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, ku është konkluduar papërshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës për sa vijon:

“Për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, administrohen informacione, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

Konkretisht, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Petrit M. Çomo disponohen të dhëna nga të cilat ngrihen dyshime për favorizim të personave në gjykim dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm.

Petrit M. Çomo ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe ngrihen dyshime se një person tjetër ka ushtruar ndikim të paligjshëm ndaj gjyqtarit Petrit Çomo, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për disa çështje gjyqësore”.

2. Gjatë procedurës së hetimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës janë kryer hapat hetimore si vijon:

2.1. Është kryer aksesi nga trupi gjykues i Komisionit, së bashku me vëzhguesen ndërkombëtare të ONM-së, në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, që i përket praktikës së verifikimit të kryer nga organet ligjzbatuese për kontrollin e kriterit të figurës, për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, me qëllim verifikimin e burimeve të informacionit që kanë shërbyer për arritjen e konkluzioneve të paraqitura nga Grupi i Punës në raportin e DSIK-së.

2.2. Aksesimi informacioneve të klasifikuara “sekret shtetëror”, u krye në mënyrë të drejtpërdrejtë duke u vënë në dispozicion të trupit gjykues të Komisionit dhe vëzhgueses ndërkombëtare të ONM-së, pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror dosja që i përket praktikës së verifikimit të kryer për kriterin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çomo, dhe informacioni i aksesuar edhe nga Grupi i Punës së DSIK-së.

2.3. Në të kundërt të sa ka arsyetuar shumica e trupit gjykues, kam vlerësuar se nga dokumentacioni i verifikuar, provat e aksesuara “sekret shtetëror”, mbështesin përfundimin e arritur prej Grupit të Punës, mbi “*ushtrim të ndikimit të paligjshëm gjatë kryerjes së detyrës*”.

2.4. Në kuadër të standardit të vendosur nga jurisprudenca e GjEDNj-së në çështjen R., kundër Republikës Çeke, provat, për shkak të natyrës së informacionit dhe kushteve specifike të ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të tij, pranë ambienteve të autoritetit kompetent shtetëror, pavarësisht se nuk mund t’i bëhen me dije subjektit të rivlerësimit janë të plota për të provuar konkluzionin e arritur në raportin e Grupit të Punës pranë DSIK-së.

2.5. Sa ka rezultuar nga provat, kam vlerësuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit mënyra e sjelljes dhe komunikimit e provuar me provat e referuara më lart, tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, ku sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare që udhëzojnë shembuj të sjelljes dhe integritetit.

2.6. Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, përcakton: “*Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të*

arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore”.

3. Përveç sa më sipër, shtetasi T.M., referuar të dhënave të bëra publike në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit ka qenë administrator i shoqërisë “****” me NIPT ***, në pronësi të z. P.B., për periudhat kohore nga data 23.5.2012 deri në datë 20.9.2012, si dhe nga data 5.12.2013 deri në datën 26.5.2015.

3.1.Korrespondenca për shtetasin T.M., nisur nga sa më sipër duhej kryer jo vetëm si individ për vitin 2014, por edhe si administrator i shoqërisë “****”.

3.2.Aksioneri i vetëm i kësaj shoqërie, z. P.B., në datën 17.10.2015, referuar të dhënave të sistemit *TIMS* është arrestuar dhe proceduar penalisht për veprën e parashikuar nga neni 283 i Kodi Penal, duke rezultuar në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar, parashikuar në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi i proceduar për një vepër penale të parashikuar nga pika 1, e nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009.

3.3.Duke marrë në konsideratë sa subjekti deklaroi se nuk kishte njohje me z.T.M., vetëm verifikimi dhe identifikimi për proceset e këtij shtetasi si përfaqësues ligjor i kësaj shoqërie do t’i mundësonte, trupit gjykues, të analizonte njohjen e subjektit me aksionerin e vetëm të kësaj shoqërie, z.P.B., për të arsyetuar mbi konkluzionin tjetër të arritur nga Grupi i Punës, sipas të cilit subjekti ndodhej në kushtet e *mos deklarimit të kontakteve të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar e cila ngarkonte subjektin e rivlerësimit Petrit Çomo me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti, e plotësisht të pasaktë dhe me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.*

3.4.Për sa në raport citohej se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe ngrihen dyshime se një person tjetër ka ushtruar ndikim të paligjshëm ndaj gjyqtarit Petrit Çomo, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për disa çështje gjyqësore, hetimi i shtrirë ndaj personit i cili referohej se kishte ushtruar ndikim të paligjshëm ndaj subjektit nuk mund të referohej dhe përdorej edhe lidhur me arsyetimin për kontaktin e papërshtatshëm, për sa në raportin e kontrollit të figurës ata identifikoheshin si dy individë të ndryshëm.

3.5.Pas shqyrtimit të dokumentacionit në drejtim të verifikimeve të kriterit të figurës, kam arritur në përfundimin se në vlerësimin tërësor, subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut të drejtësia ndaj dhe për të duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në bazë të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Xhensila Pine

ANËTARE/Kundër